

Markes “Njëqind vjet vetmi”

(fragment)

Panairi i ciganëve

Duke i shtrënguar për dore të dy djemtë e vet që të mos i humbte mes asaj rrëmuje të tmerrshme, duke u përplasur pas marifetçinjve me dhëmbë floriri dhe pas magjistarësh të tjerë që shfaqeshin secili me nga gjashtë krahë të përdredhur dhe, duke iu marrë fryma nga përzierja e erës së djersës me kundërmimin e vajrave aromatike që shpërndante turma, Hose Arkadio Buendia kërkonte gjithandej, me sy të çakërritur si një i ndërkryer, mikun e tij Melhiades, që ky t’ia zbulonte të fshehtat e pakufishme të atij spektakli të mrekullueshëm. Ai iu drejtua shumë arixhinjve, por ata nuk ia kuptonin gjuhën. Më së fundi arriti tek sheshi, ku Melhiadesi e ngrinte zakonisht çadrën e vet, dhe aty gjeti një arixhi armen fjalëpakë, por që i foli spanjisht për t’i ofruar një lloj shurupi që të bënte të padukshëm. Ai sapo kishte zbrazur me fund një kupë me atë lëngun në ngjyrën e qelbarit, kur Hose Arkadio Buendia, duke e hapur rrugën me bërryla mes turmës që po e ndiqte e nemitur atë veprim, arriti ta pyeste për Melhiadesin. Arixhiu e përfshiu me një vështrim misterioz dhe sakaq u shndërrua i tëri në një pellg zifti, të qelbur dhe avullues, mbi të cilin u ngrit pezull jehona e përgjigjes së tij.

- Melhiadesi ka vdekur.

I pikëlluar nga mandata, Hose Arkadio Buendia ngriu në vend, duke u munduar të mposhtte dhimbjen, derisa turma e kureshtarëve u shpërnda për të ndjekur një tjetër mrekulli dhe pellgu i armenit fjalëpakë u avullua në hiç. Ca më vonë, disa arixhinj të tjerë ia vërtetuan lajmin e kobshëm që Melhiadesi kishte vdekur në ranishtat e Singapurit nga një palë ethe të forta dhe që kufoma e tij ishte lëshuar në vendin më të thellë të Gjirit të Javës. Për të dy djemtë ky lajm ishte krejt i papërfillshëm; ata mezi prisnin që babai t’i merrte tani dhe t’i çonte tek zbulimi aq i lëvdur i Dijetarëve të Memfisit. Siç ishte shpallur, ky zbulim qe ekspozuar në një çadër, e cila, në lashtësi, pat qenë gjoja e mbretit Solomon. Fëmijët këmbëngulën aq shumë, saqë Hose Arkadio Buendia e zgjidhi më së fundi qesen, duke paguar të tridhjetë realet e hyrjes dhe duke i shpënë në mesin e çadrës, ku një vigan me gjoks leshtor e me kokë të rruar, me një alamet unaze bakri të shkuar tejpertej hundës e me vargonj të rëndë në kyçet e këmbëve, bënte roje pranë një sënduku piratësh. Sapo vigani e ngriti kapakun, nga sënduku vërshoi një gulç i acartë. Brenda ndodhej vetëm një kallëp shumë i madh e i tejdukshëm, i përshkuar nga damarë të panumërt, brenda të cilëve drita e mugët përthyhej në qindra yje të larmishëm. Duke e ditur fort mirë që djemtë po prisnin

prej tij një përgjigje të menjëhershme, Hose Arkadio Buendia, në hutim e sipër, arriti të murmuriste vetëm këto fjalë:

- Ky është më i madhi diamant i botës!

- Jo, - e ndreqi arixhiu. – Ky është një akull!

Hose Arkadio Buendia, i turbulluar, e zgjati dorën drejt kallëpit të akullit, por vigani ia shtyu mënjë.

- Për ta prekur, duhet të tundësh edhe pesë reales të tjera! – i tha.

Hose Arkadio Buendia ia pagoi. Pastaj vuri dorën mbi akull dhe e la disa minuta përmbi të, teksa zemra i rrihte si çekan nga frika dhe nga gëzimi që ndjeu gjatë prekjes së atij misteri. Pa ditur çfarë të thoshte, pagoi edhe dhjetë reales të tjera, që edhe djemtë të njiheshin me atë përvojë të mrekullueshme. Hose Arkadioja, djali më i madh, kundërshtoi ta prekte akullin, kurse vogëlushi Aureliano bëri një hap para, vuri dorën mbi të dhe e tërhoqi menjëherë.

- Po zien! – thirri ai i trembur.

Porse i ati nuk ia vari fare. I dehur nga ajo provë e qartë e mrekullisë, ai harroi në atë çast dështimet e sipërmarrjeve të tij të krisura si dhe kufomën e Melhiadesit, që u ishte hedhur përbindëshave të detit për t'ua shuar babëzinë e tyre të madhe. Pagoi edhe pesë reales të tjera dhe, duke e mbështetur dorën përmbi akull, bërtiti, a thua se po betohej mbi Dhjatën e shenjtë:

- Kjo është shpikja më e madhe e botës!